



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

URDHËR
PËR NDËRMARRJEN E NISMËS DHE NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR
HARTIMIN E PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË
NGURTA

Nr. 926, datë 28.12.2018

Në zbatim të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", VKM Nr. 504, datë 13.9.2017, "Për Përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë",

URDHËROJ:

1. Ndërmarrjen e Nismës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta.

2. Ngritjen e grupit të punës me përbërje si më poshtë:

- | | | |
|--------------------|---------|--|
| ▪ Hantin Bonati | Kryetar | Përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; |
| ▪ Lindita Sotiri | Anëtar | Përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; |
| ▪ Anila Morina | Anëtar | Përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; |
| ▪ Marini Veizi | Anëtar | Përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; |
| ▪ Isa Memia | Anëtar | Përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; |
| ▪ Ledjana Karalliu | Anëtar | Përfaqësues i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit; |
| ▪ Sonila Pashaj | Anëtar | Përfaqësues i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit; |
| ▪ Bledi Dimo | Anëtar | Përfaqësues i AKPT-së; |
| ▪ Erjona Vurmo | Anëtar | Përfaqësues i AKPT-së; |

3. Grupi i punës është përgjegjës për:

- **Ndjekjen e procedurave dhe Hartimin e dokumentit të Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta**, në përputhje me fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe në përputhje me përcaktimet e Rregullores së Planifikimit të Territorit;
- **Garantimin e hartimit të Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta (PKS - MMN), në përputhje** me kornizën ligjore në fuqi, planet kombëtare e strategjitë sektoriale në fuqi, parimet e planifikimit të territorit dhe në përputhje me nevojat lokale;
- **Koordinimin e punës** për të siguruar realizimin e dëgjësave publike, këshillimeve dhe bashkërendimin me të gjitha autoritetet e planifikimit të qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe palët e interesuara sipas fazave të përcaktuara në planin e veprimit;
- **Bashkëpunimin** me strukturat dhe institucione të tjera, me qëllim vijueshmërinë e punës;
- **Raportimin periodik** të Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë mbi vijueshmërinë e procesit të hartimit dhe miratimit të Planit Sektorial për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta.

4. Ngarkohet grupi i punës për zbatimin e këtij Urdhri.

5. Urdhëri Nr.530, datë 21.06.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, (Masterplani i Mbetjeve)”, shfuqizohet.

6. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Damian GJIKNURI

